

Me
Dana

18-06-2018

P.nr.2331/17

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i përgjithshëm,

Divizioni Penal gjyqtarja individuale Hakile Ilazi, me procesmbajtësin Maliq Muharremi, në lëndën penale kundër të pandehurit [REDAKTUAR], i akuzuar sipas Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.177-2/16, të dt.13.09.2017, për veprën penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 399 par. 1 nën par.5 lidhur me nenin 398 par.1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP.nr.177-2/16 të dt.13.09.2017 për dhënien e urdhrin ndëshkimor dënim me gjobë, Gjykata me dt.20.10.2017 mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET, kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.177-2/16, të dt.13.09.2017, dhe kjo Gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR], Komuna Ferizaj, i lindur [REDAKTUAR], nga i ati [REDAKTUAR] dhe e ëma [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion student, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal [REDAKTUAR], mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTORË

Se me datën 25.01.2016, rreth orës 11:30, në rrugën magjistrale Ferizaj – Prishtinë, përkatësisht në fshatin Babush, Komuna Ferizaj, gjatë një kontrolli nga ana e policisë është zbuluar se ka përdorur si të vërtetë dokumentin publik pa autorizim dhe atë targat e regjistrimit me numër [REDAKTUAR] dhe të njëjtat i ka vendosur në automjetin-tjetër të markës "Mitsubishi" me nr. të shasisë XMCLNDG1A2F015659, edhe pse e ka ditur se të njëjtat nuk i takojnë këtij automjetit, dhe të njëjtat i ka përdor për ngasjen në trafikun publik,-

-me të cilën ka kryer veprën penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 399 par. 1 nën par.5 lidhur me nenin 398 par.1 të KPRK-së

Prandaj gjykata në bazë të nenit 4,7,17,21,41,46,73, të KPRK-së si dhe nenit 495, të KPPK-së

G J Y K O N

Të pandehurin, me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mundë të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do ti shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

Gjithashtu obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP.nr.177-2/16, të dt.13.09.2017 ka akuzuar të pandehurin [REDAKTUAR] për veprë penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 399 par. 1 nën par.5 lidhur me nenin 398 par. 1 të KPRK-së dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor PP.nr.177-2/16, të dt.13.09.2017, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj veprë penale nga i pandehuri.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1.të KPPK-së.

Gjykata pasi shqyrtoj provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës si: vërtetimi mbi konfiskimin e sendit i datës 25.01.2016, raporti i oficerit i datës 25.01.2016, deklarata e të pandehurit e datës 25.01.2016, si dhe shkresat e tjera që gjinden në lëndë, vërtetojnë se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqipton dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi .

Konform nenit 450 dhe 451 të KPPK-së gjithashtu obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20, në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nga arsyet e sipër cekura, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.


GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.2331/17 datë 20.10.2017

Procesmbajtësi
Maliq Muharremi

Gjyqtarja Individuale

Hakile Ilazi



KËSHILLË JURIDIKE:

Kudër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit të njëjtës gjykatë.